



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.75

28 maj

2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.550, datë 1.5.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.160, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve, për vitin 2008, në ministrinë dhe institucionet qendrore”	3317
Vendim i KM nr.551, datë 1.5.2008	Për lejimin e kalimit transit të automjeteve dhe të trupave të kontingjentit ushtarak italian, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	3318
Vendim i KM nr.553, datë 1.5.2008	Për miratimin e programit kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, për bashkëpunimin në fushat e arsimit, shkencës, kulturës, arteve, rinisë e sporteve, medias dhe kontakteve ndërmjet njerëzve	3320
Vendim i KM nr.554, datë 7.5.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Petrelë, të qarkut të Tiranës	3332
Vendim i KM nr.555, datë 7.5.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Lekbibaj të qarkut të Kukësit	3338
Vendim i KM nr.556, datë 7.5.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Shalës, të qarkut të Elbasanit	3347

VENDIM
Nr.550, datë 1.5.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.160, DATË 13.2.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE, PËR VITIN 2008,
NË MINISTRITË DHE INSTITUCIONET QENDRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.160, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:
 - a) Në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për numrin total të punonjësve, të miratuar për vitin 2008, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:
 - i) Në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të shtohen edhe 11 punonjës, për Njësinë e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit;
 - ii) Në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të pakësohen 135 punonjës;
 - iii) Në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, për periudhën 1 korrik 2008-31 dhjetor 2008, të pakësohen 487 punonjës.
 - b) Numri total i punonjësve buxhetorë, për periudhën janar-korrik 2008, bëhet 104 592 punonjës, ndërsa për periudhën korrik-dhjetor 2008 bëhet 104 105 punonjës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Gr.	Ministritë/institucionet	janar-korrik 2008	korrik-dhjetor 2008
3	Kryeministria	128	128
	Institucione të tjera qeveritare, nga të cilat:	106	106
	- Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar	33	33
	- Agjencia e Prokurimit Publik	36	36
	- Grupi i Mbikëqyrjes	8	8
	- Komiteti Shtetëror i Minoriteteve	9	9
	- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	20	20
4	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, nga e cila:	508	508
	- Drejtoria e Standardeve	18	18
5	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, nga e cila:	2109	2109
	- Bordet e kullimit	650	650
6	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	1362	1362
10	Ministria e Financave, nga të cilat:	3108	3108
	- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	1000	1000
	- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	1630	1 630
	- Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave	22	22

11	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	43 707	43 220
	- Universitetet	3 833	3833
	- Parauniversitar	38 496	38 496
12	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	1105	1105
13	Ministria e Shëndetësisë	15408	15408
14	Ministria e Drejtësisë, nga të cilat:	4594	4594
	- Avokati i Shtetit	40	40
	- Zyra e Regjistrimit të Pasurive	400	400
	- Agjencia Kombëtare e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	150	150
15	Ministria e Punëve të Jashtme	168	168
16	Ministria e Brendshme, nga e cila:	13 065	13 065
	- Drejtoria e Rezervave të Shtetit	100	100
17	Ministria e Mbrojtjes	11 800	11 800
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	950	950
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	140	140
22	Akademia e Shkencave	45	45
25	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	1415	1415
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimi të Ujërave	1401	1401
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	82	82
50	Instituti i Statistikës	169	169
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	10	10
59	Instituti i Rehabilitimit të Përndjekurve Politikë	25	25
78	Ministria e Integrimit	77	77
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	6	6
	Totali	101 488	101 001
	Totali për institucionet e pavarura	3104	3104
	Totali i punonjësve buxhetorë	104 592	104 105

VENDIM
Nr.551, datë 1.5.2008

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË AUTOMJETEVE DHE TË TRUPAVE TË KONTINGJENTIT USHTARAK ITALIAN, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të 6 (gjashtë) autokolonave ushtarake italiane, në itinerarin Qafë-Thanë-Porti i Durrësit, në datën 8 maj 2008, si më poshtë vijon:

- Autokolona e parë përbëhet nga 25 (njëzet e pesë) automjete civile, 26 (njëzet e gjashtë) shoferë civilë, 2 (dy) automjete ushtarake dhe 4 (katër) ushtarakë.

- Autokolona e dytë përbëhet nga 12 (dymbëdhjetë) automjete dhe 26 (njëzet e gjashtë) ushtarakë.

- Autokolona e tretë përbëhet nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) automjete dhe 32 (tridhjetë e dy) ushtarakë.

- Autokolona e katërt përbëhet nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) automjete dhe 36 (tridhjetë e gjashtë) ushtarakë.

- Autokolona e pestë përbëhet nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) automjete dhe 37 (tridhjetë e shtatë) ushtarakë.

- Autokolona e gjashtë përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) automjete dhe 25 (njëzet e pesë) ushtarakë.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit.

2. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të 5 (pesë) autokolonave ushtarake italiane, në itinerarin Porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datat 10-11 maj 2008, si më poshtë vijon:

- Autokolona e parë përbëhet nga 20 (njëzet) automjete civile, 21 (njëzet e një) shoferë civilë, 2 (dy) mjete ushtarake dhe 4 (katër) ushtarakë.

- Autokolona e dytë përbëhet nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) automjete dhe 32 (tridhjetë e dy) ushtarakë.

- Autokolona e tretë përbëhet nga 15 (pesëmbëdhjetë) automjete dhe 32 (tridhjetë e dy) ushtarakë.

- Autokolona e katërt përbëhet nga 12 (dymbëdhjetë) automjete dhe 39 (tridhjetë e nëntë) ushtarakë.

- Autokolona e pestë përbëhet nga 7 (shtatë) automjete dhe 17 (shtatëmbëdhjetë) ushtarakë.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë është Porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

3. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në/nga Republika e Shqipërisë janë parashikuar në “Marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave”, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, dhe në “Marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe në protokollin shtesë të “Marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera, pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

4. Automjetet dhe trupat e kontingjentit ushtarak italian, gjatë itinerarit të lëvizjes nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

5. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.553, datë 1.5.2008

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT KUADËR, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË, PËR
BASHKËPUNIMIN NË FUSHAT E ARSIMIT, SHKENCËS, KULTURËS, ARTEVE, RINISË
E SPORTEVE, MEDIAS DHE KONTAKTEVE NDËRMJET NJERËZVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e programit kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, për bashkëpunimin në fushat e arsimit, shkencës, kulturës, arteve, rinisë e sporteve, medias dhe kontakteve ndërmjet njerëzve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PROGRAM KUADËR

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË, MBI BASHKËPUNIMIN NË FUSHAT E ARSIMIT, SHKENCËS, KULTURËS DHE ARTEVE, RINISË DHE SPORTEVE, MASMEDIAS DHE KONTAKTEVE NDËRMJET NJERËZVE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë, këtu të quajtura “Palët”,

duke vepruar në pajtim me marrëveshjen kulturore, të lidhur në Ankara, më 2 shkurt 1989, mbështetur në programin e shkëmbimeve kulturore, arsimore dhe shkencore, të nënshkruar në Tiranë, më 16 qershor 1998, dhe duke iu referuar marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë Telegrafike Shqiptare dhe Agjencisë (së lajmeve) “Anadolu”, të nënshkruar në Tiranë, më 15 korrik 1998, memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë Shqiptare të Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë Turke të Arsimit Kombëtar, të nënshkruar në Ankara, më 10 mars 2000, Protokollit të bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave Shtetërore Qendrore të Shqipërisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave Shtetërore të Kryeministrit të Turqisë, të nënshkruar në Ankara, më 28 tetor 2000, protokollit të bashkëpunimit dypalësh ndërmjet Radiotelevizionit Shqiptar dhe Korporatës Turke të Radiotelevizionit, të nënshkruar në Ankara më 12 korrik 2001, dhe marrëveshjes për bashkëpunimin shkencor ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë Turke të Shkencave dhe protokollit të saj ekzekutiv, të dyja të nënshkruara në Ankara, më 2 nëntor 2001;

vendosën t’i vinin në praktikë detyrimet dypalëshe në lidhje me këtë program me qëllim nxitjen nëpërmjet shkëmbimit dhe bashkëpunimit miqësor e mirëkuptimit më të gjerë të mundshëm në secilin prej vendeve të tyre përkatëse të aktiviteteve intelektuale, artistike, shkencore, sportive, masmedias dhe popullore, si dhe historisë dhe mënyrës së jetesës në vendin tjetër;

të vendosura për të bashkëpunuar në përcaktimin e mënyrave dhe mjeteve për një bashkëpunim më dinamik, intensiv dhe të orientuar nga rezultati sipas këtij programi, me qëllim përfshirjen, ndërmjet të tjerash, të proceseve përkatëse të integritetit të të dy vendeve në BE, duke përfshirë projekte të përbashkëta në pajtim me programet e komunitetit, sipas rastit;

me dëshirën për të bashkuar përpjekjet, kurdoherë që të jetë e mundur, veçanërisht për projekte konkrete, brenda kuadrit të Këshillit të Europës, UNESCO-s, Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE), dhe të organizatave të tjera përkatëse ndërkombëtare,

kanë miratuar programin e mëposhtëm kuadër për zbatimin e marrëveshjes së tyre kulturore.

I. ARSIMI DHE SHKENCA

1.1 Palët shkëmbejnë materiale informimi dhe publikime në lidhje me programet e tyre arsimore, sistemet arsimore dhe organizimin e arsimit në vendet e tyre.

1.2 Palët shkëmbejnë, sipas rastit, delegacione me tre anëtarë për vizita deri në dhjetë ditë për të studiuar sistemet arsimore të palës tjetër.

1.2.1 Hollësitë për shkëmbimin e delegacioneve përcaktohen me anë të kontakteve të drejtpërdrejta ndërmjet autoriteteve kompetente të të dy vendeve dhe realizohen nëpërmjet kanaleve diplomatike.

1.2.2 Pala turke përpiqet të organizojë, me bazë vjetore, një seminar me orientim pune për prezantimin e mësimdhënies së gjuhës turke, sistemit arsimor kombëtar turk dhe kulturës turke.

1.2.3 Palët inkurajojnë organizimin e kurseve të trajnimit të vazhduar edhe për arsimin profesional dhe teknik.

Neni 2

2.1 Në emër të Palëve, Ministria e Arsimit Kombëtar të Turqisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Shqipërisë shkëmbejnë atlasat, si dhe tekstet e gjeografisë dhe historisë që tashmë përdoren në arsimin fillor dhe të mesëm dhe paraqesin vlerësimet, vërejtjet dhe komentet e tyre me qëllim përfitimin e korrigjimeve të pasaktësive në to në lidhje me secilin prej të dy vendeve, duke iu referuar orientimeve të UNESCO-s dhe Këshillit të Europës dhe praktikës së vendosur ndërkombëtare.

2.2 Takimet e ekspertëve për këtë qëllim mbahen siç kërkohen nga rasti, hollësitë e të cilave shtjellohen me anë të kanaleve diplomatike.

Neni 3

Palët mbështesin krijimin e marrëdhënieve të partneritetit ndërmjet shkollave të arsimit të mesëm të të dy vendeve.

Neni 4

Palët mbështesin bashkëpunimin e drejtpërdrejtë ndërmjet universiteteve dhe institucioneve të tjera të arsimit të lartë, si dhe ndërmjet institucioneve të përfshira në kërkimet shkencore dhe teknologjinë në vendet e tyre përkatëse, veçanërisht, nëpërmjet shkëmbimit:

- të profesorëve të universiteteve dhe akademikëve ose ekspertëve të tjerë të përfshirë në kërkimet shkencore, si profesorë dhe kërkues të ftuar;
- të diplomantëve të universiteteve, kërkues, lektorë dhe specialistë, si pjesëmarrës në seminare, diskutime dhe organizime të tjera shkencore;
- të vizitorëve në laboratorë shkencorë dhe institucionet përkatëse në vendin tjetër;
- të bursave për studime ose kërkime, veçanërisht në gjuhën dhe letërsinë e secilit vend;
- të delegacioneve që dëshirojnë të studiojnë sistemet, programet, metodologjitë, materialet dhe pajisjet, si dhe infrastrukturën dhe shkëmbimit të eksperiencave;
- të literaturës shkencore.

Neni 5

5.1 Sferat specifike dhe mënyrat e bashkëpunimit, së bashku me masat financiare të tyre përcaktohen nga institucionet e interesuara të arsimit të lartë, si dhe institucionet e përfshira në kërkimet shkencore dhe teknologjinë e të dy vendeve.

5.2 Palët shkëmbejnë, nëpërmjet kanaleve diplomatike, lista të përditësuara vjetore të emrave dhe adresave të kontaktit, programeve të aktiviteteve, ofertave dhe ftesave të institucioneve të tyre përkatëse të arsimit të lartë dhe të institucioneve të përfshira në kërkimin shkencor dhe teknologjinë dhe që janë përfshirë ose të interesuar në bashkëpunimin e drejtpërdrejtë me homologët e tyre në vendin tjetër.

5.2.1 Palët tregojnë në këtë kontekst çdo program studimi që mund të jetë në gjuhën zyrtare të Palës tjetër, gjithashtu edhe në gjuhën angleze, frënge ose gjermane, në universitetet e tyre dhe institucionet politnike.

Neni 6

6.1 Palët nxisin reciprokisht njohuritë për gjuhët, letërsinë, historinë dhe kulturën e të dy vendeve.

6.1.1 Palët mbështesin dhe lehtësojnë shkëmbimin, me kërkesë, të lektorëve afatshkurtër dhe afatgjatë, në pajtim me legjislacionin e tyre përkatës.

6.1.2 Palët i japin libra dhe materiale të tjera mësimdhënëse vendit tjetër, brenda kufijve të mjeteve në dispozicion.

6.2 Pala turke vazhdon të japë mbështetje, sipas rastit, për Departamentin e Turkologjisë në Universitetin e Tiranës, Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Departamentin e Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike.

Neni 7

Palët mbështesin shkëmbimin e librave, publikimeve dhe dokumenteve ndërmjet universiteteve dhe institucioneve të të dy vendeve, veçanërisht ndërmjet Këshillit të Lartë Atatürk të Kulturës, Gjuhës dhe Historisë, duke përfshirë Qendrën Kërkimore të Asociuar Atatürk, Shoqërinë e Gjuhës Turke, Shoqërinë e Historisë Turke dhe Qendrën e Kulturës Atatürk nga Pala Turke dhe Universitetin e Tiranës dhe Akademisë Shqiptare të Shkencave nga Pala Shqiptare.

Neni 8

8.1 Palët nxisin bashkëpunimin, sipas rastit, ndërmjet Këshilli të Lartë Atatürk për Kulturën, Gjuhën dhe Historinë në Turqi, duke përfshirë institucionet e asociuara, dhe homologëve të tyre në Shqipëri, veçanërisht, Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe Institutin e Historisë, Institutin e Linguistikës dhe Letërsisë, Institutin e Kulturës Popullore, Institutin e Arkeologjisë dhe Qendrën për Fjalorin Enciklopedik Shqiptar të asociuar me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, me qëllim nxitjen e projekteve të përbashkëta shkencore në fushën e historisë, kulturës dhe arkeologjisë.

8.2 Palët vazhdojnë të mbështesin kontaktet e drejtpërdrejta dhe bashkëpunimin ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë Turke të Shkencave (TUBA), mbi bazën e Marrëveshjes për Bashkëpunimin Shkencor dhe Protokollin ekzekutiv, të nënshkruar ndërmjet të dy akademive në Ankara, më 2 nëntor 2001.

8.2.1 Palët inkurajojnë Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe Akademinë Turke të Shkencave (TUBA) të bashkojnë përpjekjet në forumet përkatëse ndërkombëtare, duke përfshirë Panelin Interakademik për Çështjet Ndërkombëtare (IAP), të gjitha Akademitë Europiane (ALLEA), dhe Këshillin Interakademik për Europën Juglindore (SEEA).

Neni 9

9.1 Palët konsultohen dhe bashkëpunojnë, sipas rastit, për aktivitetet e përbashkëta të programet e Komunitetit European në fushat e arsimit dhe kulturës, shoqërisë së informimit dhe kulturës në kontekstin e zhvillimit rajonal, sipas rastit, duke i kushtuar vëmendjen e duhur "Programit të ardhshëm për veprimin e integruar në të mësuarit e përjetshëm".

9.2 Palët mbështesin, gjithashtu përpjekjet e përbashkëta brenda programeve të kërkimit dhe zhvillimit teknologjik të BE-së, veçanërisht në pajtim me programin kuadër të 7-të të ardhshëm, sipas rastit, duke u mbështetur në kontaktet ndërmjet kërkuesve të tyre në kuadrin e Fondacionit European të Shkencës dhe forume të tjera shkencore shumëpalëshe të bashkëpunimit në Europë, si EUREKA dhe COST (Bashkëpunimi European në Fushën e Kërkimeve Shkencore).

Neni 10

10.1 Pala turke jep katërmbëdhjetë (14) bursa: katër (4) për kërkime shkencore të kryhen nga studentët në studimet master për një periudhë prej një (1) viti akademi; pesë (5) për kërkim shkencor

që kryhet nga studentët në studimet e doktoraturës për një periudhë prej një (1) viti akademik, dhe pesë (5) për dy kurse dy (2)-mujore për gjuhën dhe kulturën turke, për çdo vit akademik gjatë vlefshmërisë së programit.

10.2 Pala shqiptare jep nëntë (9) bursa: katër (4) për kërkim shkencor që të kryhet nga studentë për studimet master ose doktoraturë për një periudhë prej një (1) viti akademik, dhe pesë (5) për kurse një (1)-mujore për gjuhën dhe letërsinë shqipe, për çdo vit akademik gjatë vlefshmërisë së programit.

10.3 Palët rishikojnë, sipas rastit, numrin dhe objektin e bursave, duke marrë parasysh kërkesat e palës tjetër, dhe komunikojnë çdo vit, përmes kanaleve diplomatike, specifikimet për kategori të ndryshme të bursave që do t'u jepen qytetarëve nga pala tjetër për atë vit akademik.

Neni 11

11.1 Palët shkëmbejnë informacion me qëllim që të ndihmojnë në përcaktimin e ekuivalencës së diplomave dhe të bëjnë çdo përpjekje të mundur për të nxitur dhe lehtësuar njohjen reciproke të diplomave, gradave dhe titujve akademikë të dhëna nga institucionet arsimore të vendeve të tyre përkatëse.

11.2 Pala turke pranon studentë nga Shqipëria për studimet universitare në universitetet, turke, me kusht që këta studentë të përmbushin kërkesat e ligjit turk, veçanërisht ato të përcaktuara në aktin e arsimit të lartë dhe akteve nënligjore përkatëse dhe pranimin e kriterëve për universitetet përkatëse turke.

11.3 Pala shqiptare pranon studentë nga Turqia për studimet universitare, me kusht që këta studentë të jenë të përshtatshëm për arsimin e lartë edhe në bazë të ligjit turk.

11.4 Palët nxisin konsultimet dhe bashkëpunimin, sipas rastit, ndërmjet autoriteteve të tyre kompetente mbi bazën e procesit të Bolonjës.

II. BIBLIOTEKAT DHE ARKIVAT

Neni 12

12.1 Palët nxisin kontaktet dhe bashkëpunimin e drejtpërdrejtë ndërmjet bibliotekave publike, veçanërisht bibliotekave kombëtare të të dy vendeve, për qëllimin e shkëmbimit të materialeve të informimit dhe publikimeve të tjera.

12.2 Palët shkëmbejnë dy punonjëse bibliotekare nga bibliotekat kombëtare ose biblioteka të tjera publike të secilit vend për vizita studimore deri në dhjetë ditë me qëllim familjarizimin e tyre me organizimin dhe funksionimin, dhe lehtësimin e kontakteve dhe bashkëpunimin e drejtpërdrejtë me libraritë e tyre publike.

12.3 Palët inkurajojnë kontaktet e drejtpërdrejta ndërmjet organizatave të bibliotekave të tyre në kuadrin e organizatave ndërkombëtare, si Federata Ndërkombëtare e Shoqatave të Bibliotekave (IFLA).

12.4 Palët ftojnë punonjës bibliotekash dhe kërkues nga vendi tjetër në takime shkencore ndërkombëtare në këtë fushë për t'i organizuar në vendet e tyre përkatëse.

12.5 Palët shkëmbejnë mikrofilma të dorëshkrimeve të bibliotekave të tyre publike për të pasuruar koleksionet e tyre, në masën që është parashikuar në legjislacionin e tyre përkatës të brendshëm.

Neni 13

13.1 Palët vazhdojnë të inkurajojnë bashkëpunimin e drejtpërdrejtë ndërmjet administratave të tyre përkatëse të arkivave të shtetit duke u mbështetur në protokollin e bashkëpunimit të 28 tetorit 2000.

13.2 Palët nxisin bashkëpunimin në masën që është parashikuar nga legjislacioni i tyre përkatës i brendshëm dhe në pajtim me praktikat e vendosura ndërkombëtare, veçanërisht në:

- shkëmbimin e inventarëve të dokumenteve në arkivat e tyre përkatëse shtetërore, në lidhje me historinë e vendit tjetër;

- shkëmbimin e kopjeve të dokumenteve arkivore, mikrofilmave, arkivave elektronike, katalogëve dhe indekseve, me qëllim pasurimin e koleksioneve të tyre;
- shkëmbimin e dy arkivistëve, secili për vizita studimore deri në dhjetë ditë, me qëllim që të familjarizohen me organizimin dhe funksionimin e arkivave të tyre shtetërore edhe me teknologjitë moderne të zbatuara për konservimin dhe rinovimin e arkivave;
- ftesën e arkivistëve nga vendi tjetër në takime shkencore ndërkombëtare në këtë fushë që organizohen në vendet e tyre përkatëse dhe në ekspozitat me modellet e riprodhuara të materialeve arkivore.

III. KULTURA DHE ARTET

Neni 14

Palët mbështesin përkthimin dhe publikimin, dhe organizimin e seminareve mbi poezinë dhe veprat letrare nga autorë të shquar nga vendi tjetër.

Neni 15

15.1 Palët informojnë njëra-tjetrën mbi panairët ndërkombëtare të librit dhe ekspozitat që organizohen në vendet e tyre përkatëse dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga pala tjetër në këto aktivitete.

15.2 Palët mbështesin pjesëmarrjen reciproke në panairët ndërkombëtare të librit që organizohen në të dy vendet, veçanërisht në Panairin Ndërkombëtar të Librit në Stamboll.

Neni 16

1.6.1 Palët mbështesin bashkëpunimin e drejtpërdrejtë ndërmjet institucioneve, organizatave dhe shoqatave të tyre përkatëse, të producentëve të filmit dhe arkivave të filmit, veçanërisht në lidhje me prodhimin e filmave, sigurimin e shërbimeve të bërjes së filmit, prezantimin dhe shpërndarjen e filmave nga vendi tjetër.

16.1.1 Palët nxisin iniciativat e tyre të përbashkëta në prodhimin e filmit, duke përfshirë punën përgatitore, si për prodhimin, ashtu edhe për shpërndarjen.

16.2 Palët nxisin zgjerimin e ftesave të drejtpërdrejta, kurdoherë që kjo është e mundur, për profesionistët e filmit dokumentar dhe artistik, veçanërisht, drejtorëve, aktorëve/aktoreve, skenaristëve dhe personelit teknik, nga pala tjetër, në festivalet ndërkombëtare të filmit që organizohen në vendet e tyre përkatëse.

16.3 Palët inkurajojnë shkëmbimin e kërkuesve për studimin e filmit.

16.4 Palët lehtësojnë organizimin reciprok të javëve të filmit në vendet e tyre përkatëse, dhe shkëmbimin e delegacioneve të përbëra deri në tre persona në këto raste.

16.4.1 Hollësitë teknike dhe të tjera në lidhje me organizimin e javëve të filmit përcaktohen nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta ndërmjet autoriteteve kompetente të të dy vendeve dhe zgjidhen nëpërmjet kanaleve diplomatike dhe të tjera për të cilat bihet bashkërisht dakord.

Neni 17

17.1 Palët mbështesin bashkëpunimin në fushën e dramës, veçanërisht në lidhje me pjesët e teatrit të skenës nga dramaturgë të shquar nga të dy vendet.

17.2 Palët mbështesin shkëmbimin e profesionistëve të teatrit, veçanërisht aktorëve, drejtorëve, koreografëve, disenjatorëve të dekorit dhe kostumeve, për të vënë në skenë dhe luajtur pjesë teatrore, edhe të kërkuesve, kritikëve dhe ekspertëve për studimet e teatrit dhe seminarët dhe të delegacioneve për projekte të përbashkëta në fushën e teatrit.

17.3 Palët bëjnë ftesa dhe lehtësojnë pjesëmarrjen reciproke në festivalet ndërkombëtare të teatrit që mbahen në vendet e tyre përkatëse.

17.4 Palët lehtësojnë disponibilitetin e teksteve të pjesëve teatrore, koleksionet e imazheve dhe burime të tjera, duke përfshirë, nëse është e mundur, në gjuhën angleze.

Neni 18

18.1 Palët ftojnë dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e vëzhguesve, anëtarëve të jurisë, artistëve dhe ansambleve nga vendi tjetër në konkurse dhe festivale ndërkombëtare të muzikës, operës, baletit dhe valleve që mbahen në vendet e tyre përkatëse.

18.2 Palët nxisin në degë të ndryshme të arteve debutuese, veçanërisht muzikë, opera, balet dhe valle, shkëmbimin e solistëve, kompozitorëve, dirigjentëve, koreografëve, disenjatorëve të dekorit/kostumeve dhe profesionistëve të tjerë, edhe ansamble të vogla artistike, profesionistë dhe amatorë, mbi bazën e marrëveshjeve që përcaktojnë termat financiarë dhe të tjerë.

18.3 Palët inkurajojnë kontaktet e drejtpërdrejta dhe bashkëpunimin ndërmjet organizatave turke të arteve debutuese, duke përfshirë Drejtorinë e Përgjithshme të Operës dhe Baletit Shtetëror, Fondacionin e Stambollit për Kulturën dhe Artet, Fondacionin e Izmirit për Kulturën dhe Arsimin, SCA-në, Fondacionin Muzikor dhe homologët e tyre shqiptarë.

Neni 19

19.1 Palët nxisin shkëmbimet e ekspozitave të arteve dhe mjeshtërive popullore dhe shkëmbimin e ekspertëve të arteve popullore.

19.2 Palët nxisin shkëmbimin e artistëve dhe grupeve artistike të muzikës folklorike dhe valltarëve folklorikë edhe të teatrit të kukullave dhe teatrit hije.

19.3 Palët inkurajojnë pjesëmarrjen e ansambleve të muzikës popullore dhe të valleve në festivalet ndërkombëtare popullore që organizohen në të dy vendet.

19.4 Palët inkurajojnë në sferën e folklorit pjesëmarrjen e Palës tjetër në konferencat, kongreset, kolokiumet, simpoziumet dhe takime të tjera ndërkombëtare që organizohen në vendet e tyre përkatëse dhe nxisin shkëmbimin e publikimeve të tyre.

Neni 20

20.1 Palët inkurajojnë dhe lehtësojnë organizimin e përbashkët të “Javëve/ditëve të kulturës”, dhe në këto raste shkëmbejnë delegacione me deri në tre ekspertë.

20.1.1 Hollësitë në lidhje me organizimin e “Javëve/ditëve të kulturës” përcaktohen nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta ndërmjet autoriteteve kompetente të të dy vendeve, dhe finalizohen nëpërmjet kanaleve diplomatike ose të tjera për të cilat bihet bashkërisht dakord.

Neni 21

21.1 Palët, me përjashtim të ekspozitave të trashëgimisë kulturore, mbështesin bashkërisht organizimin e ekspozitave të artit, veçanërisht të mjeshtërive tradicionale, artit modern, arteve figurative dhe plastike, që shoqërohen me një ose dy komisionerë, në pajtim me legjislacionin e tyre përkatës të brendshëm.

21.1.1 Për masat bihet dakord rast pas rasti nga institucionet e interesuara. Hollësitë, duke përfshirë edhe termat financiarë, përcaktohen me anë të kanaleve diplomatike ose kanaleve të tjera për të cilat bihen dakord bashkërisht.

21.2 Palët mbështesin, gjithashtu pjesëmarrjen e përbashkët në ekspozitat dhe bienalet dhe simpoziumet e arteve të bukura që mbahen në vendet e tyre përkatëse. Për termat dhe kushtet e shkëmbimit bien dakord organizatorët rast pas rasti.

Neni 22

22.1 Palët bashkëpunojnë për mbrojtjen dhe konservimin e trashëgimisë kulturore dhe historike të të dy vendeve, në pajtim me konventat përkatëse të Organizatës Arsimore, Shkencore dhe Kulturore të Kombeve të Bashkuara (UNESCO) dhe të Këshillit të Europës ku ato janë Palë, veçanërisht Konventën në lidhje me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore botërore të vitit 1972, dhe Konventën Kulturore Europiane të vitit 1954.

22.2 Palët bashkëpunojnë në hartimin e një inventari të relikeve dhe monumenteve turke

kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme në Shqipëri, dhe atë të relikeve dhe monumenteve shqiptare të luajtshme dhe të paluajtshme në Turqi.

22.3 Palët bashkëpunojnë në fushën e arkeologjisë, muzeologjisë dhe restaurimit të monumenteve dhe antikuarëve kulturore.

22.3.1 Palët presin deri në tre ekspertë nga vendi tjetër për t'i familjarizuar ata me muzeumet e tyre, secili për një periudhë që nuk i kalon pesëmbëdhjetë ditët.

22.3.2 Palët shkëmbejnë ekspertë, sipas rastit, për deri në dhjetë ditë në fushën e restaurimit dhe ruajtjes së dorëshkrimeve.

22.4 Palët ftojnë ekspertë nga vendi tjetër për të marrë pjesë në kongreset ndërkombëtare, simpoziumet dhe ekspozitat në lidhje me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, veçanërisht të monumenteve historike.

22.5 Palët mbështesin sesionet e përbashkëta të fushës praktike për studentët e Akademive të Arteve të Bukura nga të dy vendet; duke iu referuar, veçanërisht ruajtjes së veprave të artit.

22.6 Palët konsultohen dhe bashkërendojnë përpjekjet për të parandaluar importin, eksportin dhe transferimin e paligjshëm të pronësisë mbi pasuritë kulturore dhe të rimarrin antikuarët e vjedhura, kryesisht sendet e lashta dhe fetare, mbi bazën e detyrimeve të tyre përkatëse ndërkombëtare dhe legjislacionit kombëtar.

22.7 Palët shkëmbejnë informacionin dhe eksperiencat në lidhje me legjislacionin dhe praktikën e tyre përkatëse në lidhje me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, duke i kushtuar vëmendjen e duhur luftës kundër trafikimit të veprave të artit.

Neni 23

23.1 Palët mbrojnë, në pajtim me legjislacionin e tyre përkatës të brendshëm, si dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare ku ato janë palë, të drejtat e autorit të qytetarëve dhe institucioneve të palës tjetër, në masën që ato të drejta kanë të bëjnë me programin.

23.2 Palët shkëmbejnë informacionin, dokumentacionin dhe publikimet mbi legjislacionin e tyre përkatës, dhe, me kërkesë, ekspertizë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale.

23.3 Palët informojnë njëra-tjetrën për konferencat ndërkombëtare, diskutimet nëpër panele, simpoziume dhe takime të tjera për të drejtat e pronësisë intelektuale që mbahen në vendet e tyre përkatëse.

23.4 Palët konsultohen dhe bashkëpunojnë, sipas rastit, brenda Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT), Organizatës Botërore për Pronësinë Intelektuale (OBPI) dhe brenda organizatave përkatëse ndërkombëtare, në lidhje me çështjet me interes të përbashkët në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale në përgjithësi dhe të të drejtave të autorit në veçanti.

Neni 24

Palët konsultohen dhe bashkëpunojnë, sipas rastit, në bazë të programeve të komunitetit në fushat e kulturës dhe arteve dhe veçanërisht "Kultura 2007", sipas rastit.

IV. RINIA DHE SPORTET

Neni 25

25.1 Palët inkurajojnë kontakte dhe bashkëpunim të drejtpërdrejtë ndërmjet institucioneve të tyre përkatëse të sporteve dhe edukimit fizik, duke përfshirë me anë të lidhjes së protokolleve të bashkëpunimit mbi objektin, format dhe termat organizative dhe financiare, dhe kushtet e shkëmbimit në këtë fushë.

25.2 Palët nxisin në fushat e rinisë dhe sporteve shkëmbimin e ekspertëve, informacionit dhe publikimeve ndërmjet shoqatave dhe organizatave të interesuara.

25.3 Palët inkurajojnë pjesëmarrjen e përbashkët në aktivitetet, ngjarjet dhe festivalet e rinisë dhe sporteve, të organizuara në vendin tjetër.

25.3.1 Palët inkurajojnë institucionet e tyre të arsimit fillor dhe të mesëm të zgjerojnë

bashkërisht, me anë të kanaleve diplomatike, ftesat për homologët e tyre në vendin tjetër për pjesëmarrje në kampet verore, aktivitetet sportive dhe festivalet folklorike që organizohen në vendet e tyre përkatëse në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

25.3.2 Institucionet partnere arrijnë marrëveshje me anë të kontakteve të drejtpërdrejta mbi specifikat e shkëmbimeve në të ardhmen (numrin e pjesëmarrësve, masat organizative dhe financiare).

V. MASMEDIA

Neni 26

26.1 Palët u japin asistencë anëtarëve të shtypit dhe medias nga vendi tjetër në kryerjen e punës së tyre profesionale në vendet e tyre përkatëse.

26.2 Palët vazhdojnë të mbështesin kontaktet dhe bashkëpunimin e drejtpërdrejtë ndërmjet shërbimeve të tyre përkatëse të shtypit dhe informimit, agjencive të lajmeve, korporatave të radios dhe televizionit, agjencive të shtypit dhe gazetave.

26.2.1 Palët nxisin konsultimet dhe bashkëpunimin, sipas rastit, ndërmjet zyrave të tyre qeveritare të komunikimit, që janë Drejtoria e Përgjithshme Turke e Shtypit dhe Informimit (BYEGM) dhe Departamentit Shqiptar të Informacionit.

26.2.1.1 Palët nxisin shkëmbimin e ekspertizës ndërmjet zyrave të tyre qeveritare të komunikimit në fushat e “menaxhimit të krizave” dhe “menaxhimit të çështjeve”.

26.2.1.2 Palët presin reciprokisht një delegacion me dy anëtarë secili nga zyra qeveritare e komunikimit të vendit tjetër për një periudhë deri në pesë ditë për të parë mënyrat e mundshme dhe mjetet për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet dy zyrave.

26.2.2 Palët vazhdojnë të nxisin kontakte dhe bashkëpunim të drejtpërdrejtë ndërmjet Agjencisë “Anadolu” (A.A.) dhe Agjencisë Telegrafike Shqiptare (ATA), mbi bazën e marrëveshjes së bashkëpunimit të 15 korrikut 1998.

26.2.3 Palët vazhdojnë të inkurajojnë kontaktet dhe bashkëpunimin ndërmjet Korporatës Turke të Radiotelevizionit dhe Radiotelevizionit Shqiptar mbi bazën e protokollit dypalësh të bashkëpunimit të 12 korrikut 2001.

26.3 Palët mbështesin shkëmbimin e përfaqësuesve nga bota e shtypit dhe medias me qëllim nxitjen e një mirëkuptimi më të thellë të përbashkët të jetës ekonomike, politike, kulturore dhe sociale që mbizotëron në vendin tjetër dhe për shkëmbimin e mendimeve mbi aktivitetet e gazetarisë.

26.3.1 Palët presin reciprokisht një grup me tre gazetarë të rinj dhe tre gazetarë të vjetër nga shtypi dhe media e vendit tjetër për një periudhë prej pesë ditësh.

26.4 Palët konsultohen dhe bashkëpunojnë, sipas rastit, në bazë të programeve përkatëse të Komunitetit, veçanërisht “Media 2007”, sipas rastit.

VI. KONTAKTET NDËRMJET NJERËZVE

Neni 27

27.1 Palët mbështesin kontaktet e drejtpërdrejta ndërmjet njerëzve dhe ndërmjet organizatave të shoqërisë civile të të dy vendeve, me qëllim nxitjen e një mirëkuptimi më të mirë reciprok.

27.2 Palët vazhdojnë të mbështesin përfundimin e memorandumeve të mirëkuptimit për krijimin e marrëdhënieve të binjakëzimeve ndërmjet qyteteve të interesuara të të dy vendeve, duke përfshirë ndërmjet Ankara-Tirana, Stamboll-Durrës, Uskudar (Stamboll)-Shkodër.

27.3 Palët konsultohen dhe bashkëpunojnë, sipas rastit, sipas programeve përkatëse të komunitetit, veçanërisht “Rinia në veprim” dhe “Kultura 2007”, sipas rastit.

VII. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE FINANCIARE

A. SHKËMBIMI I INDIVIDËVE TË NDRYSHËM NGA BURSISTËT

Neni 28

28.1 Pala dërguese njofton palën pritëse, parimisht, të paktën gjashtë (6) javë para datës së

planifikuar të mbërritjes në lidhje me synimin e saj për të dërguar individë në bazë të këtij programi, duke dhënë emrat e tyre, kualifikimet/titujt profesionalë/akademikë/artistikë, gjuhët që fliten (gjuhën e vendit pritës ose gjuhën angleze), qëllimin e vizitës, programin e propozuar të punës dhe kohëzgjatjen e qëndrimit.

28.2 Pala pritëse i jep palës dërguese pëlqimin e saj me shkrim për vizitën e propozuar, parimisht tre (3) javë para datës së planifikuar të mbërritjes.

28.3 Pala dërguese njofton palën pritëse në lidhje me datën e saktë dhe mjetin e transportit, parimisht, të paktën dhjetë (10) ditë para datës së planifikuar të mbërritjes.

Neni 29

Pala dërguese, nëse nuk është rënë dakord ndryshe, mbulon shpenzimet e transportit ndërkombëtar për në dhe nga vendi i aktivitetit (ose, në rast se kjo nuk është e mundur, qyteti më i afërt ku shkohet me transport ajror ndërkombëtar) për vizitorët që shkëmbehen në bazë të këtij programi.

Neni 30

Vizitorët që shkëmbehen në bazë të këtij programi për periudha që nuk i kalojnë pesëmbëdhjetë (15) ditë, nëse nuk është rënë dakord ndryshe, e kanë strehimin dhe ushqimin e tyre, si dhe, në masën që është e mundur, shpenzimet për udhëtimin e brendshëm të vendit tjetër, në pajtim me rregullat e brendshme, të paguara nga subjektet që i presin ata në emër të palës pritëse.

Neni 31

Palët sigurojnë, mbi bazë reciproke dhe në pajtim me legjislacionin e tyre përkatës të brendshëm, trajtimin mjekësor emergjent në ambientet publike të kujdesit shëndetësor të vendeve të tyre përkatëse për vizitorët nga pala tjetër sipas këtij programi. Shpenzimet e trajtimeve afatgjata, operacionet e mëdha kirurgjikale dhe protezat dentare nuk mbulohen.

B. SHKËMBIMI I BURSISTËVE

Neni 32

32.1 Palët informojnë çdo vit njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, në lidhje me dispozitat e përgjithshme dhe financiare që rregullojnë shkëmbimin vjetor të bursave, deri më 31 mars.

32.2 Pala dërguese i paraqet palës marrëse formularët për kërkesa nga kandidatët në pajtim me kushtet dhe termat e caktuara për bursat përkatëse.

32.2.1 Kërkesat (pyetësorët dhe shtojcat) për bursat dhe kurset verore paraqiten nëpërmjet Ambasadës së Republikës së Turqisë në Tiranë në lidhje me vizitat në Turqi dhe nëpërmjet Ambasadës së Shqipërisë në Ankara në lidhje me vizitat në Shqipëri, brenda afateve të caktuara nga autoritetet arsimore të të dy vendeve.

32.3 Përzgjedhja e kandidatëve për bursa kryhet nga komisioni i autorizuar nga Pala dërguese, që përfshin një përfaqësues nga ambasada e vendit që ofron bursën.

32.4 Lista e kandidatëve të suksesshëm përfshin edhe kandidatët rezervë, kandidatët që nuk përfshihen në listat zyrtare nuk kanë të drejta për bursa në bazë të këtij programi.

32.5 Lista e kandidatëve për bursa i komunikohet palës pritëse me anë të kanaleve diplomatike.

32.6 Palët njoftojnë njëra-tjetrën nëse kandidatët për bursa dhe programet e tyre të propozuara të studimit pranohen dhe në cilat institucione arsimore janë regjistruar bursistët rreth datës 30 shtator, në të njëjtin vit.

32.7 Bursistët shkojnë në vendin pritës vetëm pasi të kenë marrë një komunikim formal nga

përfaqësia diplomatike e palës pritëse në datat në të cilat bursa e tyre hyn në fuqi.

32.8 Pala dërguese informon palën pritëse në lidhje me kohën e saktë të mbërritjes së bursistëve, parimisht dy (2) javë përpara.

Neni 33

33.1 Pala turke siguron sa më poshtë për bursistët shqiptarë për kërkimet:

- tarifat e mësimdhënies në universitetet shtetërore;
- një bursë mujore për të mbuluar shpenzimet e akomodimit dhe jetesës, të dhënë dhe përshtatur, sipas rastit, me koston mbizotëruese të jetesës, në pajtim me legjislacionin e brendshëm turk.

Pala turke siguron sa më poshtë për bursistët shqiptarë për kurset e verës:

- tarifat e mësimdhënies;
- një bursë mujore;
- fjetjen.

33.2 Pala Shqiptare u siguron bursistëve turq për kërkime:

- një bursë mujore të caktuar në nivelin e caktuar për studentët e huaj, që mbulon shpenzimet e akomodimit dhe jetesës;
- një mundësi për të ndjekur studimet në institucionet publike të arsimit të lartë sipas kushteve të pagesës që zbatohen për qytetarët e Shqipërisë.

Pala shqiptare u siguron pjesëmarrësve të kurseve verore:

- akomodimin;
- përjashtimin nga tarifat e mësimdhënies.

Neni 34

Palët mbulojnë shpenzimet e udhëtimeve ndërkombëtare të shtetasve të tyre që përfitojnë nga bursat e dhëna nga pala tjetër, së pari kur ata udhëtojnë në vendin tjetër të bëjnë studimet, dhe së dyti udhëtimin e kthimit në vendet e tyre pas përfundimit ose pezullimit të studimeve të tyre.

C. SHKËMBIMI I LEKTORËVE

Neni 35

35.1 Kërkesa për pranimin e një lektori ose zgjatjen e punësimit për një vit tjetër akademik i paraqitet palës tjetër rreth datës 31 maj të çdo viti.

35.2 Një institucion i arsimit të lartë që synon të punësojë një lektor në bazë të këtij programi është i detyruar të lidhë marrëveshje punësimi që cakton termat dhe kushtet e punësimit, duke përfshirë objektin e detyrave dhe numrin e orëve të mësimi.

D. SHKËMBIMI I ANSAMBLEVE

Neni 36

36.1 Pala dërguese mbulon shpenzimet e udhëtimit dhe transportit të mjeteve të ansambleve për në destinacionin e parë në vendin pritës dhe kthimin nga ai i fundit për në vendin e origjinës ose në një vend të tretë.

3.2 Pala pritëse përballon shpenzimet e qëndrimit dhe udhëtimet e brendshme të ansambleve dhe mbulon të gjitha shpenzimet e tjera në lidhje me organizimin e shfaqjeve.

36.3 Pala dërguese jep të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me ansamblet (emrat e debutuesve, datat e mbërritjes dhe largimit, programet, materiale të shkruara etj.), të paktën tre muaj para shfaqjes së parë.

36.4 Çdo çështje tjetër financiare në lidhje me shkëmbimin e ansambleve negociohet drejtpërdrejt ndërmjet organizatorëve të shfaqjeve të të ftuarve.

E. SHKËMBIMI I EKSPOZITAVE

Neni 37

37.1 Në marrjen e masave për ekspozitat sipas këtij programi, përveç atyre të trashëgimisë historike, termat dhe kushtet e përgjithshme që respektohen nga institucionet, nëse nuk bihet dakord ndryshe, janë si më poshtë:

37.1.1 Përgjegjësitë e palës dërguese:

- paraqitja e propozimeve të detajuara për ekspozitat, duke përfshirë të dhënat e nevojshme teknike, parimisht, dymbëdhjetë (12) muaj para datës së planifikuar të hapjes;
- sigurimi i transportit ndërkombëtar për në destinacionin e parë të vendit pritës dhe transportin ndërkombëtar nga vendndodhja e fundit në vendin e origjinës ose në një vend të tretë;
- dhënia e garancisë për transportet e afërta;
- dhënia e informacionit dhe materialeve të nevojshme për realizimin e një katalogu në gjuhën e palës pritëse, dhe/ose në gjuhën angleze gjashtë (6) muaj para hapjes së ekspozitës.

37.1.2 Përgjegjësitë e palës pritëse janë:

- sigurimi falas i sallave të përshtatshme për ekspozitat me infrastrukturën e nevojshme të sigurisë (kushte klimaterike, rojë etj.);
- shpejtimi dhe lehtësimi i procedurave të vizave për komisionerët e ekspozitave dhe procedurave të doganave për importin dhe eksportin e materialeve të ekspozitave;
- sigurimi i personelit të nevojshëm për ngarkimin dhe shkarkimin, paketimin dhe shpaketimin, montimin dhe çmontimin e objekteve që ekspozohen dhe materialeve të tjera të ekspozitës;
- realizimi i katalogut dhe, nëse është e nevojshme, i posterave dhe ftesave;
- nxitja e ekspozitave për një publik më të gjerë, veçanërisht me anë të mjeteve të shtypit dhe medias;
- dorëzimi në vendin e origjinës i kopjeve të materialeve promovuese të nxjerra në lidhje me ekspozitën, katalogë, postera, ftesa, rishikime etj.);
- dhënia, në rast dëmtimi, i të gjithë dokumentacionit përkatës, duke përfshirë raportin zyrtar të dëmtimit, dhe asistencën për t'i mundësuar palës dërguese të paraqesë pretendimet për kompensim të shoqëritë përkatëse të sigurimeve.

37.1.3 Për të gjitha kushtet e tjera bihet dakord rast pas rasti.

37.2 Në rast dëmtimi, pala pritëse nuk fillon me restaurimin e sendeve të ekspozuara, nëse nuk merret leje me shkrim shprehimisht nga pala dërguese nëpërmjet kanaleve diplomatike.

37.3 Të gjitha kushtet në lidhje me organizimin e ekspozitës negociohen dhe specifikohen në një marrëveshje të veçantë që lidhet ndërmjet institucioneve që kanë organizuar ekspozitën dhe institucionit që ka dërguar ekspozitën.

37.4 Shpenzimet për organizimin e evenimenteve për qëllime tregtare caktohen ndërmjet agjencive të interesuara të të dy vendeve, rast pas rasti.

F. LËSHIMI I VIZAVE DHE LEJEVE TË QËNDRIMIT, IMPORTI/EKSPORTI I PÛRKOHSHËM I MATERIALEVE

Neni 38

38.1 Asgjë në këtë program nuk konsiderohet të ndikojë në detyrimin e çdo personi të respektojë ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi në territorin e çdo pale në lidhje me hyrjen, qëndrimin dhe largimin e të huajve.

38.2 Palët lehtësojnë dhe shpejtojnë bashkërisht lëshimin e vizave për individët, ansamblet dhe grupet që shkëmbehen në bazë të këtij programi, dhe për lejet e qëndrimit, sipas rastit.

38.3 Palët lehtësojnë dhe shpejtojnë bashkërisht importin/eksportin e përkohshëm të objekteve dhe materialeve të nevojshme për zbatimin e misionëve ose aktiviteteve sipas këtij programi.

VIII. DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 39

39.1 Për zbatimin e të këtij programi, palët mblidhen të paktën një herë në vit, në mënyrë të

alternuar në Shqipëri dhe Turqi, në formën e një komisioni të përbashkët, që cakton, sipas rastit, rregullat e veta të procedurës.

39.1.1 Komisioni i përbashkët vlerëson dhe përcakton *ad referendum* mënyrën e zbatimit në të ardhmen të këtij programi.

39.1.2 Ngjarjet e veçanta, aktivitetet ose projektet diskutohen në takimet vjetore ose nëpërmjet kontakteve përmes kanaleve diplomatike.

39.2 Për zbatimin e këtij programi, Palët mund të përfundojnë plane veprimi në të ardhmen.

39.3 Planet e veprimit vjetore/shumëvjeçare përcaktojnë objektivat e përgjithshëm, sferat prioritare dhe perspektivat financiare, sipas rastit, për bashkëpunimin që Palët synojnë të marrin përsipër brenda vitit përkatës kalendarik.

39.4 Të gjitha aktivitetet, sipas këtij programi, kryhen me dijeninë e Ministrive të Punëve të Jashtme të të dy vendeve, duke i kushtuar vëmendjen e duhur parimit të reciprocitetit dhe brenda kufijve të mundshëm financiarë dhe të tjerë të palëve.

39.5 Palët e zbatojnë këtë program në pajtim me marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare të cilat ato të dyja janë Palë Kontraktuese dhe mbi bazën e legjislacionin të tyre përkatës të brendshëm, sipas rastit.

